



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2012
Nr. ref.: RK243/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI16/12

Parashtruesi

Gazmend Tahiraj

Vlerësim kushtetues i Aktgjkimit të Gjykatës Supreme A. nr. 1415/2011, të datës 30 dhjetor 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Gazmend Tahiraj nga fshati Terdevc, Glogovac.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 1415/2011, të 30 dhjetorit 2011, i cili nuk dihet se kur i ishte dorëzuar atij.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), më saktë neni 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale].
4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Baza Juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 1 mars 2012, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 5 mars 2012, Gjykata ua komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale – Departamentit të Administratës Pensionale.
9. Më 7 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 14 dhjetor 2004, Departamenti i Administratës Pensionale miratoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për pensionin e aftësisë së kufizuar në pajtim me Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. Kjo e drejtë për pension të aftësisë së kufizuar do të rishqyrtohej pas tri vjetësh nga data e fitimit të kësaj të drejte.
11. Më 16 shtator 2010, Komisioni mjekësor rivlerësoi situatën e parashtruesit të kërkesës dhe Departamentit të Administratës Pensionale, dhe konsideroi se parashtruesi i kërkesës i plotëson kërkesat e parapara me Ligjin Nr. 2003/23 Pensionet e personave me aftësi të kufizuar, dhe i vazhdoi të drejtën për pension të aftësisë së kufizuar.
12. Më 15 shkurt 2011, Komisioni mjekësor rivlerësoi përsëri situatën e parashtruesit të kërkesës dhe më 22 mars 2011, Departamenti i Administratës Pensionale konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet e parapara me Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar dhe rrjedhimisht refuzoi kërkesën për pension të aftësisë së kufizuar.

13. Më 16 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës u ankua ndaj këtij vendimi tek Komisioni për ankesa në Departamentin e Administratës Pensionale.
14. Më 20 tetor 2011, Komisioni për ankesa refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte respektuar afatin ligjor për parashtrim të ankesës. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pranoi vendimin e kontestuar më 22 mars 2011, përderisa parashtruesi ankesën më 16 shtator 2011, d.m.th. më shumë se 14 ditë nga dita e dorëzimit të vendimit në fjalë. Parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën e konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme kundër atij vendimi.
15. Më 30 dhjetor 2011, Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. nr. 1415/2011) refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazë. Gjykata Supreme konkludoi se Departamenti i Administratës Pensionale mori vendimin më 22 mars 2011, përderisa parashtruesi i kërkesës kontestoi vendimin më 16 shtator 2011. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme vlerësoi se Komisioni i ankesave, duke hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ka zbatuar drejt ligjin kur ka konkluduar se ankesa ishte parashtruar pas afatit të paraparë kohor.
16. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dokumentacion mbështetës dhe as informacion që do të arsyetonte kërkesën e tij për moszbulim të identitetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme “*në mënyrë të njëanshme po më mohon të drejtën për pension të aftësisë së kufizuar*”.
18. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 51 [Mbrotja shëndetësore dhe sociale] të Kushtetutës dhe nenet 1, 2, 3, 4 të Ligjit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Gjykata vëren se për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.
20. Neni 113. paragrafi 1 dhe 7 i Kushtetutës parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
21. Në anën tjetër, rregulli 36 1 (c) i Rregullores së punës parasheh që “*Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.*”
22. Para së gjithash, parashtruesi i kërkesës nuk i parashtrroi ankesë Komisionit të ankesave në Departamentin e Administratës Pensionale brenda afatit ligjor.
23. Në fakt, Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka parashtruar ankesën e tij brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 10.1 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar.

24. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesi i kërkesës të shter të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkelje të tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesi i kërkesës duke dështuar për të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i tij deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen.
25. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektivën e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar një parashtrues kërkesë nga detyrimet e tij për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtrës nr. 20357/92, DR 76, fq.80).
26. Siç u tha më sipër, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përmbledhen në një ankesë se procedurat ishin kryer në "*mënyrë të njëanshme*" dhe ishin të padrejta.
27. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në tërësi, përfshirë edhe se nëse mënyra se si janë marrë ato dëshmi, kanë qenë të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Vidal kundër Belgjikës, Aktgjykimi i 22 prillit 1992, Seria A nr. 235-B, pp. 32-33, para. 33).
28. Në vazhdim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk duhet vepruar si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
29. Si përfundim, Gjykata vetëm mund të vlerësojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të ndershme, dhe nëse procedurat në përgjithësi, parë si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të ndershëm (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
30. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thjeshtë konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar plotësisht ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e tij. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se pse dhe si Gjykata Supreme vendosi "*në mënyrë të njëanshme*", duke mohuar të drejtën e tij për pension të personave me aftësi të kufizuar.
31. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tija në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundojë se procedurat relevante në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ Vendimi për Pranueshmëri Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).

32. Nga e gjithë kjo, rrjedh se kërkesa është e papranueshme për arsye të mosshterjes së mjeteve ligjore të ofruara me ligj dhe, edhe po që se të shteruara, kërkesa është qartazi e pabazë në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.
33. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për moszbulim të identitetit, Gjykata e refuzon si të pabazë, sepse nuk ka ofruar dokumentacion dhe informata mbështetëse lidhur me arsyet se pse parashtruesi i kërkesës nuk dëshiron t'i zbulohet identiteti.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të rregullit 36 (1.c) dhe rregullit 56 (2) të Rregullore së punës, më 7 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ta hedhë poshtë kërkesën e tij për moszbulim të identitetit;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani